

Kastrioti/ Mile debuton ndaj Partizanit

nga AlbaniaSoccer

E mërkurë, 20 Nentor 2013 17:12



Kastrioti ka ndryshuar trajner dhe per here te pare ne krye te skuadres do te vihet Kristaq Mile. Ne takimin e pare, ai do te drejtoj skuadren e tij kunder Partizanit ne nje ndeshje te veshtire. "Dy javet e pauzes se kampionatit na sherbyen per te mesuar nga njeri tjetri, une nga lojtaret dhe ata nga une. Luajme ne transferte kunder Partizanit nje ndeshje te veshtire por ne do te synojme me te miren. Kjo skuader ka me shume mundesi dhe lojtaret jane ne borxh me veten dhe te gjithë tifozet per aq pak sa kane bere ne fazen e pare", keshtu ka deklaruar Kico Mile ne prag te ndeshjes se pare me Kastriotin.